Breaking News: DVP Vlorë/Arrestohet në flagrancë një 14-vjeçar që drejtonte automjetin në mënyrë të mezikshme dhe nuk ku bind urdhrit të Policisë

Komunikata

01/04/2026

Raporti I Ngjarjeve, 1 Prill 2026

DVP Tiranë/Ndalohen 2 shtetas të tjerë në kërkim, në vijim të operacionit të koduar "Catch".

Si rezultat i kontrolleve dhe punës informative, shërbimet në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, gjatë kësaj faze të operacionit "Catch", lokalizuan dhe ndaluan 2 shtetas të shpallur në kërkim. Konkretisht:

-shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale, në bashkëpunim me specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare, kapën shtetasin D. S., 55 vjeç, i cili është dënuar nga Gjykata e Tiranës, me 4 vjet e 8 muaj burgim, për veprën penale "Mashtrimi";

-shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 5, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Rinas, kapën shtetasin D. A., 26 vjeç, për të cilin, Gjykata e Tiranës ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprën penale "Vjedhja", kryer në bashkëpunim;

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve arrestuan shtetasit E. M., 38 vjeç dhe A. D., 26 vjeç, pasi shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja, i njetën secilit, sasi Kokaine. Lënda narkotike për të dyja rastet u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Trafiqeve referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetaset e huaja, R. M. dhe C. C., pasi ushtronin prostitucion në apartamente të marra nga secila, me qira.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-K. M., pasi dyshohet se ka mashtruar subjektin ku punonte, duke mos i shlyer një detyrim financiar;
-V. L., pasi dyshohet se nëpërmjet mashtrimit, i ka marrë shuma parash, shtetasex R. M.;
-F. A., pasi dyshohet se nuk ka paguar qiranë për një automjet, me të cilin gjithashtu dyshohet se ka lëvizur jashtë shtetit, pa autorizimin e subjektit qiradhënës.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 ndaluan shtetasen F. D., e cila është dënuar me 15 ditë burgim, për veprën penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 shpallën në kërkim shtetasit:
-I. Sh., pasi dyshohet se me automjetin që drejtonte, ka përplasur automjetin e shtetasit F. A.;
-A. Xh., 31 vjeçe, pasi dyshohet se ka përplasur me automjetin që drejtonte, automjetin e shtetasves M. K., të cilën gjithashtu dyshohet se e ka kanosur;
-F. M., pasi dyshohet se nëpërmjet mashtrimit, i ka marrë një shumë parash, shtetasit J. B..
Punohet për shoqërimin e 3 shtetasve, si dhe për sqarimin e mëtejshëm të rasteve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3:
-arrestuan shtetasin A. Sh., 31 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj nënës së tij;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin G. A., pasi dyshohet se për motive pronësie, ka kanosur xhaxhanë e tij;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit D. P. dhe L. P., pasi dyshohet se për motive të dobëta, kanë kanosur shtetasin Sh. H.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin D. H., pasi dyshohet se ka kanosur ish-të dashurën e tij, nëpërmjet thirrjeve/mesazheve telefonike.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. A., pasi dyshohet se aksidentalisht, gjatë punës në subjektin që administron, është dëmtuar shtetasi A. R., 41 vjeç, i cili është në kujdesin e mjekëve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6 shpallën në kërkim një të mitur, pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me grushte, një shtetase. Punohet për kapjen e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Krujë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit S. V. dhe B. P., pasi dyshohet se për motive të dobëta, janë konfliktuar fizikisht, me njëri-tjetrin.

Specialistët e qarkullimit rugor:
-arrestuan shtetasin F. LL., 37 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjet, në gjendje të dehur;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin Sh. D., pasi me motorsipërin që drejtonte, ka përplasur këmbësoren, shtetasen A. Sh., 42 vjeçe, e cila është në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen E. Ç., pasi me automjetin që drejtonte, ka përplasur këmbësoren, shtetasin V. H., 70 vjeç, i cili është në kujdesin e mjekëve.

Dje, kalibzoi shtetasja H. B., se në një fjalë fiqare në njëte sociale, bëheshin postime fyese për të. Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve të rastit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

DVP Vlorë / Vijojnë goditjet kundër krimeve ndaj pronës , arrestohen 3 shtetas për vjedhje të ndodhur në Vlorë dhe Sarandë

Në vijim të punës për zbardhjen e rasteve të vjedhjeve dhe si rezultat i veprimeve intensive hetimore, shërbimet e Policisë kanë bërë të mundur identifikimin dhe arrestimin e 3 shtetasve të dyshuar për vepra penale kundër pronës.

Në lidhje me një rast vjedhjeje me dhunë, të ndodhur më datë 30.03.2026, mëh orëve të mbrëmjes, në lagjen "1 Maji", në qytetin e Vlorës, u arrestuan dy autorët e dyshuar, të cilët i kanë vjedhur me dhunë portofolin me një shumë parash shtetases J. K., 39 vjeçe, banuese në Vlorë.
Shtetasit e arrestuar janë:

-B. T., 18 vjeç;
-një 16-vjeçar;
të dy banues në Vlorë.

Gjatë kontrollit ndaj tyre, specialistët e seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Vlorë, gjetën dhe sekuestruan shumën monetare të vjedhur, në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë Vlorë, për veprën penale "Vjedhja me dhunë, e kryer në bashkëpunim".

Gjithashtu, më datë 30.03.2026, rreth orëve të pasdites, në qytetin e Sarandës, një shtetas ka vjedhur nga automjeti i shtetasit L. T. një çantë, në të cilin ndodheshin dokumente personale dhe çelësa.

Falë reagimit të shpejtë dhe punës së mirëorganizuar të Policisë, u bë i mundur arrestimi në flagrancë i autorit të dyshuar:
N. Ç., 66 vjeç, banues në Sarandë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë Sarandë për veprën penale "Vjedhja".

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë

Më datë 31.03.2026, specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare të DVP Vlorë ekzekutuan vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i lënë në fuqi me vendimin nr. 10, të datës 25.03.2026, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shtetasin J. G., 60 vjeç, banues në Himarë.
Me këtë vendim, shtetasi J. G. është dënuar me 6 muaj e 10 ditë burgim, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë.

Specialistët e Seksionit të trafikut Urban dhe Interurban të DVP Vlorë referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin K. Gj., 35 vjeç, banues në Vlorë, pasi në rrugën "Gjergj Kastriot", dyshohet se ka përplasur me automjetit, një 68-vjeçare, këmbësore, ka braktisur automjetin dhe është larguar nga vendi i aksidentit. 68-vjeçarja po merr mjekim në spital dhe është jashtë rrezikut për jetën. Punohet për kapjen e tij.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vlorë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin E. A., 39 vjeç, banues në Vlorë, pasi dje, në një automjet në pronësi të tij (aktualisht jofunksional) u gjetën dhe u sekuestruan 2 ndezës granatash.

Materialet procedurale iu referuan prokurorive kompetente, për veprime të mëtejshme.

Qarku Durrës

Specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin F. F., 45 vjeç, banues në Tiranë, pasi dyshohet se ka trafikuar një automjet, i cili nga ekspertimi teknik rezultoi me numër shasie të klonuar. Automjeti u sekuestrua.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin K. H., 33 vjeç, banues në Sukth, me detyrë përgjegjëse sektori në një subjekt, pasi disa punonjëse e subjektit është dëmtuar gjatë punës, në dorë, nga një send metalik.
Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin D. S., 23 vjeç, banues në Shkallnur, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë fizike ndaj vëllait të tij. Punohet për kapjen e 23-vjeçarit.
U kap shtetasi në kërkim Sh. F., 29 vjeç, banues në Durrës, i dyshuar për veprën penale "Dhuna në familje". Pas komunikimit me Prokurorin, u vendos që ky shtetas të procedohet në gjendje të lirë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kavajë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin F. X., 34 vjeç, banues në Kavajë, pasi gjatë një konflikti, ka goditur me grushte një 52-vjeçar.

Specialistët e DVKM Durrës referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin E. C., 29 vjeç, banues në Kukës, pasi në hyrje të SPK Port Durrës, nga verifikimit e kryera automjeti i tij rezultoi i vjedhur në vitin 2025, në Kanada.

Specialistët për Kontrollin e Kontenierve referuan materialet në Prokurori, për vlerësim, pasi në Terminalin e Kontenierve të Portit Detar Durrës, është konstatuar se një kontenier kishte dëmtime në gjesën e parme të tij dhe se i mungonte plumbçja e sigurisë. Paraprakisht dyshohet se dëmtimet mund të jenë shkaktuar gjatë ngarkimit apo shkarkimit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-Gj. Gj., 58 vjeç, banues në Vaun e Dejës dhe Y. G., 69 vjeç, banues në Shkodër, pasi secili ushtronte veprimtari në subjekt tregtar, pa e regjistruar në organet tatimore;
-A. A., 35 vjeçe, banuese në Shkodër, pasi nga verifikimet e kryera në lokalin që administronte u konstatua se nuk lëshonte kupona tatimorë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Shkodër referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-L. A., 23 vjeç, banues në Shkodër, pasi është konfliktuar fizikisht me shtetasin J. O., 20 vjeç, banues në Shkodër, për motive të dobëta;
-M. H., 21 vjeç, banues në Shkodër, si dhe për një shtetas 15 vjeç, pasi ka kalëzuar shtetasi Gj. P., 25 vjeç, me së datë 31.03.2026, 15-vjeçari i ka marrë çantën ku mbante sendet personale dhe nuk ia ka kthyer më, si dhe se është konfliktuar me shtetasin M. H., i cili e ka goditur me grusht.

Më datë 01.04.2026, u gjet në bashkëpunim me shërbimet e Stacionit të Policisë Fushë Krujë dhe u dërgua në banesën e saj, në gjendje të mirë shëndetësore, shtetasja B. H., 36 vjeçe, për të cilën kishte kalëzuar vëllai i saj, më datë 31.03.2026, se ishte larguar nga banesa.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare ndaluan shtetasin E. Q., 38 vjeç, banues në Përmet, pasi dyshohet se gjatë periudhës 2019-2025, kur ka qenë i punësuar llogaritar/arkëtar në degën e Postës Shqiptare në Përmet, ka vjedhur shuma të konsiderueshme parash nga arka e postës.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Kibernetike referuan materialet në Prokurori, pasi ka kalëzuar shtetasi F. Z., 44 vjeç, banues në Memaliaj, se i kanë përdorur të dhënat e tij personale për të krijuar nëpërmjet sistemeve kompjuterike, një llogari bankare dhe karta debiti në një bankë në Spanjë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

DVP Vlorë

Vlorë/Arrestohet në flagrancë një 14-vjeçar që drejtonte automjetin në mënyrë të mezikshme dhe nuk ku bind urdhrit të Policisë. Dënohen 2 punonjës Policie gjatë detyrës.

Specialistët e Seksionit të Trafikut Urban dhe Interurban në Komisariatin e Policisë Vlorë, në bashkëpunim me oficerin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë së Vlorës, kryen veprimet procedurale për arrestimin në flagrancë të një shtetasi 14 vjeç.

Shërbimet e Patrullës së Përgjithshme, rreth mesnatës, në lagjen "24 Maj", kanë konstatuar një automjet që drejtohej nga i mituri, i cili po kryente manovra të mezikshme në rrugë. Shërbimet e Policisë i kanë bërë shenjë për ndalim, por drejtuesi nuk i është bindur urdhrit, ka ritur shpejtësinë dhe ka tentuar të godasë shërbimet e policisë me automjet.
Pas disa minutash ndjekjeje, në vendin e quajtur "Kinoteatri", shërbimet të tjera Policie i kanë bërë sërish shenjë për ndalim, por ai ka vijuar lëvizjen dhe ka goditur automjetin e Policisë, duke shkaktuar dëmtimin e 2 punonjëseve të Policisë në detyrë.
Në vijim të ndjekjes, drejtuesi ka braktisur automjetin dhe ka tentuar të largohet me vrap, por është kapur dhe vënë në pranga nga shërbimet e Policisë.

Dy punonjësit e Policisë të dëmtuar morën ndihmë mjekësore në spitalin e Vlorës dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

Veprimet procedurale u kryen në prani të psikologut, mbrojtësit ligjor dhe nënës së të miturit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trajtimin e të miturve.
Automjeti që drejtonte 14-vjeçari u blokua, ndërsa pronares së automjetit (nënës së tij) iu pezullua leja e drejtimit dhe iu vendos masë administrative, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor.
Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale:
"Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik",
"Drejtimi i automjetit në mënyrë të pamegullë",
"Shkatërrimi i pronës".

Policia e Shtetit apelon për të gjithë prindërit që të ushtrojnë kontrollë dhe përgjegjësi të vazhdueshme prindërore, duke mos lejuar në asnjë rast drejtimin e automjetave nga të mituriti, pasi këto veprime rezikojnë seriozisht jetën dhe shëndetin e tyre, të përdoruesve të tjerë të rrugës, si dhe të vetë punonjësve të Policisë.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Lushnjë arrestuan shtetasin Th. K., 67 vjeç, banues në Lushnjë, pasi dyshohet se ka ngacmuar seksualisht një 16-vjeçare.

Kërko
Enter a word for search

Komisariati Dixhital
GET IT ON Google Play
Download on the App Store

Arkiva
Select Month

Linqe
Arkiva
Akademia e Sigurisë
Ministria e Brendshme
Agencia e Mbikëqyrjes Policore
Interpol
Europol
Misioni PAMECA V
SCPA
Projekti Trivalent